2.3.6Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) mjete transporti, nga te cilat nje frigoriferike ATV për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikate pronesie ose kontrate qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjeno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, certifikate transporti (te paraqitet automjet i cili pajiset me kete certifikate sipas legjislacionit ne fuqi), librezat shendetesore si dhe lejet e drejtimit te drejtuesve te mjeteve.

Ne lidhje me piken e mesiperme ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike,ne varesi te marreveshjes se bashkepunimit secili prej anetareve te bashkimit duhet te plotesoje kriterin e mesiperm ne perputhje me marreveshjen e bashkepunimit.(sipas % te kontrates se bashkepunimit).

2.3.7 Operatori ekonomik te paraqese regjistrat e monitorimit te temperaturave per periudhen e vitit 2019 per Frigoriferët e instaluar në ambientet e ushtrimit te aktivitetit sipas Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 22datë 25.11.2010 “*Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor*”.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te operoje duke plotesuar standartet ne fuqi per sigurine ushqimore. Per kete, ai duhet te paraqese vetdeklarim, ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

Operatori ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin te paraqese dokumentacion provues, ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

- Specifikimi i Materialeve: Te gjitha ushqimet koloniale te jene ne perputhje me standartet dhe cilesine e miratuar nga Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit (AKU),te jene te ambalazuara ne kushtet dhe parametrat e Standarteve te cilesise dhe te kene te etiketuara daten e prodhimit dhe te skadences.
- Per te gjithë artikujë afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës/ ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

Te gjitha ushqimet te jene brenda parametrave dhe standarteve te miratuara nga Ministria e Bujqesise dhe ushqimit si me poshte:

BUKË ME MIELL GRURI - Bazuar ne STASH 1411\87

Lloji: Bukë gruri me miell rreze 75 %

Treguesit shqisorë:

1.Korja:

E lëmuar, pa pjesë të djegura, pa çarje dhe shpëputje të kores nga tulli. Ngjyra e njëllajtë e kuqerremtë në kafe të çelët.

2.Tuli:

Masa e njëllajtë e pjekur mirë, me pore të shpërndara mirë, në mënyrë të njëllajtë. Pa gjurmë mielli të pabrumosur. Konsistenca elastike, jo i thërmueshëm, pa shtresa.

3.Era dhe shija:

E këndshme, karakteristikë e bukës së pjekur mirë. Pa erë myku, thartirë dhe hidhërimi dhe erë e shije tjetër të huaj. Nuk lejohet kërcitje.

4.Forma:

E rregullt, pa shtypje dhe deformime.

5.Lëndët e huaja:

Nuk lejohen.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Lagështira në % jo më shumë se 45

Poroziteti në % jo më pak se 70

Aciditeti në gradë jo më shumë se 4.5

Amballazhimi:

Çdo bukë të futet në qese letre e pastaj ne qese telefoni me masën 1000 gr, këto të futura në kuti

kartoni. Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes.
Transporti i bukës:

Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Ushqime me origjine Shtazore

Mish Vici cilesi e pare.

Mishi duhet te jete brenda standarteve shtetore dhe i certifikuar per konsum. Te jete mish i freket vendi, pa ere, te jete i forte, kufome ose kofshe e pasme (trung), me peshe jo me te madhe se 100 kg, Pamja e jashtme te jete me siperfaqja e jashtme e mbuluar me nje cipe te holle tharje, siperfaqja e mishit te ftohur menjehere pas prerjes te jete i tejdukshem, tendinat te jene te ndritshme, elastike dhe te forta. Mishi te jete me ngjyre roze dhe i dhjemit te jete me ngjyre te bardhe. Me ere te kendshme, karakteristike e llojit.

Çdo furnizim damkoset me vulen e kontrollorit veterinar e sanitar dhe me vulen e llojit e te cilesise se mishit.

Çdo parti mishi shoqerohet me çertifikaten veterinare me te cilen vertetohet gjendja e tij e mire shendetsore per shitje ne treg (konsum).

Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e bleresit.

“MISH PULE”(kofshe pule)

Mish pule (kofshe pule) e cilesise se pare, i paketuar ne kutite origjinale me vulen e garancise se skadences.Te sillet me mjete frigoriferike i gateshem per tu gatuar.

Malli te jete i shoqeruar me certifikat e cilesie me te gjithë parametrat.

Pjesa e kerkeses **“MISH PULE”(kofshe pule) duhet te jete e vulosur me vulen e kontrollit veterinar.**

Cdo parti /kerkese mishi pule (kofshe pule)duhet te shoqerohet me certificate veterinare ,e cila garanton sigurine e produktit ‘mish pule (kofshe pule)’dhe ne te cilen vertetohet se,nga kontrolli i kryer nuk eshte prekur nga semundjet ,por qe eshte i sigurt dhe se lejohet te tregtohet per konsum public.

Qumesht te fresket

Qumeshti duhet te jete brenda standarteve shtetore dhe i certifikuar per konsum. Qumeshti te jete prodhuar brenda dites mundesisht nga mjelja e pare ne mengjes pasi dhe konsumi do te jete ditor. Qumeshti te kete karekteritikat tipike te qumeshtit i cili ka ngjyre pak te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera, i kulluar dhe me perqindje yndyre deri ne 2%, aciditet 17 – 19, ngarkesa mikrobike 1 – 2 milion / 1 ml, mbetja e thate 10 – 12. Transporti do te kryhet ne ene alumini te standartit shtetor. Furnizimi do te behet sipas kerkese ditore te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Korce me mjetet e furnitorit. Qumeshti duhet te jete i prodhuar e grumbulluar brenda kushteve standarte higjenike te Ministrise se Bujqesise dhe Ministrise se Shendetsise. Furnizimi do te jete ditor sipas kerkeseve te Drejtorise se Sherbimit Spitalor dhe ne funksion te nevojave te saj.

Prodhimi te jete i shoqeruar me certificate te analizes te bere nga laboratorit veterinar.

Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e bleresit nga ora 07⁰⁰ – 09⁰⁰.

Djathe

Djathi kerkohet me baze prodhim neprodukt i qumeshtit te lopes, deles, ose dhise. Nuk lejohet prodhim i djathit me perzierje qumesht pluhur ose te kodensuar. Ngjyra te jete sipas llojit te qumeshtit , djathe lope, ne ngjyre te qumeshtit (krem), i deles dhe dhise te kete ngjyren kerkteristike te qumeshtit i bardhe (kur djathi eshte prodhuar me baze qumeshti delje ose dhie, dhe ngjyre kremi kur djathi eshte prohduar nga qumeshti i lopes)

Lejohet djathe me perqindje yndyre jo me shume se 3 %. Pamja e jashtme te jete konforme, ne brendesi poroze karekteristike e djathit te stazhionuar mire. Sasia e kripes te jete normale. Shija te jete e mire karekteristike e djathit normal pa erera te tjera jo te kendshme. Ambalazhimi te jete i shoqeruar deri 10 – 14 % kripe deti i mbyllur me kapak hermetik ne menyre qe te mos rrjedhe. Nuk lejohet me afat skadence me shume se nje vit. Malli te jete i shoqeruar me certificate te cilesise dhe te standarteve te miratuara.

Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit, data e stazhionit dhe data e skandences.

Furnizimi me djathe dhe gjalpe do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e bleresit.

Gjarp - Bazuar ne STAZH 1445\87

Treguesit shqisorë:

1.Pamja:

E njëtrajtshme, pa shtresa, në prerje e sipërfaqe të shënditura pa pika uji dhe mbeturina dhalli.

2.Ngjyra:

Krem deri në të verdhë të çelur.

3.Era dhe shija:

E këndshme, karakteristike e gjalpës pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit kimik:

Lageshtira në % ,jo me shumë se 17.

Lëndët e thatë pa yndyr në e %, jo më shumë se 2.

Kripë në %, jo më shumë se 2 gjalpi i kripur.

Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi:

Ambalazhohet në kuti kartoni të valëzuar me masë 1- 5 kg, të veshur nga brenda me letër pergamen.

Mbi çdo ambalazh me gjalpë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme

dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënime të detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës origjinale.

Malli të shoqërohet me fletë analize laboratorike, çertifikatë orgjine.

Ruajtja dhe transportimi:

Gjalpi ruhet në frigorifer në temperaturë 2-4 °C,

Transportimi i gjalpit nga një rreth në tjetrin bëhet me mjete frigoriferike. Transportimi bëhet me mjet të mbuluar e të pastër, i cili është i destinuar për transportimin e prodhimeve ushqimore.

VEZE PULE bazuar ne STASH 1515-85

Treguesit cilësorë vezës së pulës:

1. *Pamja e jashtme:*

E pastër dhe pa plasje. Lejohet ndotje të lehta.

2. *Dhoma e ajrit:*

Lartësia, jo më shumë se 9 mm.

3. *E bardha e vezës:*

E dendur e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar në ovoskop).

4. *E verdha e vezës:*

Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e lëvizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror.

5. *Era:*

Pa erë prishje dhe erë tjetër të huaj.

6. *Masa:*

Jo më pak se 40 gr.

AMBALAZHIMI:

Vezët ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë secila dhe në çdo kuti kartoni vendosen 12 copë kartona fole.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen. Emri i ndërmarrjes prodhuese, sasia, data e prodhimit.

Furnizimi do të kryhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri në magazinat e blerësit.

REÇEL

STASH 1477/87

Lloji i reçelit:

1. *Reçel frutash*

Sasia dhe lloji i reçelit do të jetë sipas kërkesës së AK.

Treguesit cilësorë të reçelit:

1. Pamja e ngjyra: E mirë, me fruta me ngjyrë të njëjlojtë, karakteristike e llojit, pa bërthamë dhe farë.
2. Shija dhe era: Me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamalizimi e fermentimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

Konsistenca:

Masë e njëjlojtë, viskoze deri xhelatinoze me fruta me zierje normale.

Treguesit kimik:

1. Lëndët e thata sipas refraktometrit në 20 gradë C jo më pak se 65 %
2. Sheqer gjithësej (sheqer saharoz dhe I vetë frutit) jo më pak se 55%
3. Aciditeti i shprehur në acit tartik jo më shumë se 1.3
4. Përmbajtja e kriprave të metaleve të rënda në mg/kg produkt jo më shumë se:

Kallaji	100
Bakri	10
Zinku	10
Plumbi	0.1
Arseniku	0.2

5. Shenja myku dhe fermentimi nuk lejohen

6. Lëndë të huaja nuk lejohen.

Raport analiza Fiziko – kimike duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Public Health Sector

Ambalazhimi:

Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi ose plastike, apo me peshe 300 gr - 5 kg, me etikete dhe te jete i shoqeruar me raport te rregullt analize sipas legjislacionit ne fuqi.

Cilesia e recelit duhet te jete ne perputhje me lenden e pare qe eshte perdour per prodhim dhe sipas kerkese se Autoritetit kontraktor.

Marketimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Pesha neto

Data e prodhimit .

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Produkti duhet të shoqerohet me:

Raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport analizë mikrobiologjike.

Zarzavate dhe Fruta

Zarzavatet:

DOMATE - Bazuar në STASH 1726-88

1. Pamja e jashtme:

Të fresketa, me forme tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pavrara, të pashtypura, pakalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit, të paprekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të palagura.

2. Pjekuria dhe ngjyra

Me pjekuri normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate të tejpekura, të zbutura e të vyshkura.

3. Dëmtime e sëmundje:

Nuk lejohen.

4. Të palsura e të vrara lehtësisht:

Për llojet e mesme dhe të vona lejohen deri në 5% plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje lëngu (të kalçifikuara), madhësia e kokrrës (diametri më i madh gjerësor), jo me pak se:

Për të hershmet 5 cm.

Për të mesmet dhe të vonat 7 cm.

Për të mesmet e të vonat kumbullore (gjatësia 5 cm).

KASTRAVEC - Bazuar në STASH 1754\88

Treguesit cilësorë të kastravecit:

1. Pamja e jashtme:

Të freskët me ngjyrë e forme tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë.

1. Përbërja e brendshme e tulit:

Me tul të fortë e të lëngshëm. Farat e pa zhvilluara e pa kore të fortë.

2. Madhësitë:

Gjerësia (diametric me i madh) deri në 5 cm, Gjatësia në cm nuk kërkohet.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lekura) në % jo më shumë se 2.

3. Të prekura nga insektet, të kalbura:

Nuk lejohen.

QEPE bazuar në STASH 1755\88

Treguesit cilësorë të qepës së njomë dhe të thatë:

QEPE E THATË:

1. Pamja e jashtme:

Me pjekuri të plotë. Me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota. Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

2. Diametri (madhësia e kokrrës):

për ovalet 4-8 cm.

për llojet e tjera 5-10 cm.

3. Dëmtime mekanike:

Cifla, bishta, sëmundje, lejohen jo më shumë se 1 % e parties me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja (cifla, bishta).

4. Me sëmundje:

Nuk lejohen.

5. Të ngrira, të kalbura e të mykura:

Nuk lejohen.

SPECA - Bazuar në STASH 1756\88

Treguesit cilësorë të specës:

1. Pamja e jashtme:

Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, të freskta, të pastra dhe me pjekuri teknike.

1. Dëmtime:

Të shtypura, të gervishtura jo më shumë se 3 %

2. Shija:

Karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegëse e lehtë. Nuk lejohet përzierje e specave djegës me ato jo djegës

3. Gjatësia:

Për të gjatat mbi 10 cm.

Për të rrumbullaktat mbi 7 cm.

PRESH - Bazuar në STASH 1759-88

Treguesit cilësorë të preshit:

1. Pamja e jashtme

I freskët i pastër i njomë, me ngjyrë të bardhë në jeshile, i pavyshkur dhe i lare me ujë të pijshëm.

- Diametri në pjesën me të trashë të jetë 2.5 - 3.5 cm.

- Gjatësia e kërcellit të jetë 25-45 cm.

- Gjatësia e gjethit nga rozeta të jetë jo më shumë se 20 cm.

- Sistemi rrënjorjo më shumë se 1 cm.

2. Dëmtime e sëmundje

Nuk lejohen

KARROTA

Treguesit cilësorë të karrotës:

1. Pamja e jashtme:

Të freskët me ngjyrë të verdhë në të kuqerremtë, formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë, të jenë të pastruar me ujë të pijshëm nga balta.

2. Përbërja e brendshme e tulit:

Me tul të fortë, me bosht të hollë, me diametër jo më shumë se 1 cm.

3. Madhësitë:

Gjerësia (diametric me i madh)deri në 4 cm, Gjatësia 10 -15 cm.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkur) në % jo më shumë se 2.

4. Të prekura nga sëmundjet, insektet e të kalbura:

Nuk lejohen.

PATLIXHANE - Bazuar në STASH 1730\88

Treguesit cilësorë të patëllxhanit:

1. Pamja e jashtme:

Karakteristike e kultivarit, të fresketa, të pastra, me sipërfaqe të lëmuar me ngjyrë të zezë manushaqe me pjekuri normale me fletë jeshile me nuanca të dobëta manushaqe, të pa vyshkura.

2. Dëmtime e sëmundje:

Nuk lejohen.

3. Të kalbura, të mykura, të ngrira

Nuk lejohen.

4. Madhësia:

a) diametri jo më shumë se:

Për të gjatat 5 cm;

Për të rrumbullaktat 12 cm;

gjatësia e bishtit jo më shumë se 4 cm.

BAMJA

Kërkohen të jenë të freskëta, të shëndosha, të pastra, me fije normale për kultivarin dhe fara që duket lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuar. Forma të jetë e nje prizmi shumëkëndësh që ngushtohet në majë, të pa drunjëzuara e pa fije.

Gjatësia e cilësisë së parë për bamjen frutshkurtër të jetë deri në 6 cm dhe për atë frutgjatë të jetë deri në 8 cm.

Lejohet deri në 5 % të partisë me vyshkje të lehtë. Nuk lejohet me sëmundje e dëmtues.

Ngjyra të jetë tipike për kultivarin.

Fruti të jetë i butë, me fara të vogla në fazën e qumështit.

Lejohet me fruta të tejpjekura deri në masën 2% për cilësinë e parë.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1491-88.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88.

KUNGULL

Treguesit cilësorë të kungullit:

1. *Pamja e jashtme:*

Karakteristike e kultivarit, të freskëta, të pastra, me sipërfaqe të lëmuar me ngjyrën e vetë natyrale me pjekuri normale të pa vyshkura.

2. *Dëmtime e sëmundje:*

Nuk lejohen.

3. *Të kalbura, të mykura, të ngrira*

Nuk lejohen.

Spinaq : Kërkohet cilësi e parë, i freskët, i njome, i pastër me ngjyrë jeshile të erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje të pastër, i lidhur në dendje të vogla deri në një kg. Me rrenje të prera, gjatësia e kercellit të mos jete me shume se 5 cm, të mos ketë prani të barerave të tjera, gjethet të jenë të plota me gjerësi deri në 10 cm dhe gjatësi e gjethes deri në 20 cm., gjethet të jenë pa njolla të ngjyrës së ndryshkut, pa dëmtime nga krimbat, pa dëmtime mekanike, të freskëta dhe të pavyshkuara.

PATATE - Bazuar në STASH 1729\88

Treguesit cilësorë të patates verore e dimërore:

1. *Pamja e jashtme:*

Të plota, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipik të kultivarit.

2. *Pjekuria:*

Kokrra të pjekura.

3. *Madhësia e kokrrës (diametrik më i madh) mbi:*

për të rrumbullaktat dimërore – 5 cm; verore – 4 cm.

për vezaket dimërore dhe verore – 4 cm.

për të zgjaturat - 3.5 cm.

4. *Lejohen:*

a. lehtësisht të gjelbra jo me shume se 3 % për dimëroret; 1 % për veroret;

b. të mbira jo më shumë se 1 % për dimëroret dhe nuk lejohen për veroret;

- c. lehtësisht të vyshkura jo më shumë se 3 % për dimëroret dhe 2 % për veroret;
- d. të çara, të prera e të plasura nga goditjet nuk lejohen;
- e. të kalbura nga lagështira vetngrohja, fitoftora, bryma, ngrica, nga sëmundje e dëmtues nuk lejohen;
- f. zgjebe me plagë deri në 1\5 e sipërfaqes së kokrrës jo më shumë se 1 %.
- g. njolla bojë hiri e ndryshkur deri në 1\5 e sipërfaqës së kokrrës nuk lejohen;
- h. dëmtime nga krimbi jo më shumë se 1 % .
- i. Dëmtime nga doseza nuk lejohen.

Bazuar në STASH 1789\88

Kokrra të pjekura për patatet verore lejohen me lëkur që hiqen.

Për patatet dimërore nuk lejohet që lëkura të ndahet nga tuli.

Të pastra në sipërfaqe me formë ,ngjyrë e sytha tipik të kultivarit.

Nuk lejohen kokra me ngjyrë jeshile, të vyshkura, të mbira, të çara, të plasaritura në sipërfaqe dhe të prekura në pjesën e tulit.

Përsa i përket pures së patates ajo duhet të ketë treguesit e mësipërm të patates, dhe duhet të jetë e paketuar në qese të vendosura në kuti kartoni, ku të tregohen treguesit fiziko kimik 350-750 gr.

Ushqime koloniale

MIELL GRURI

Treguesit shqisorë:

1.Pamja:

Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

2.Ngjyra:

E bardhë

3.Era dhe shija:

E këndshme, karakteristike e miellit të grurit, pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Të jetë i cilësisë së parë, i stazhionuar, i amballazhuar në pako 1 kg letre, me etiketë prodhuesi dhe afat skadence të shënuar.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

ORIZ

Treguesit shqisorë:

1.Pamja e jashtme:

Kokrra të shëndosha, të pastëra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije, pa shënja myku ose prishje.

2.Ngjyra:

E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.

3.Era dhe shija:

Karakteristikë e orizit të shëndoshë pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:

Të jetë me pako prej letre 1 kg neto. Në amballazhin të jetë shënuar edhe afati i skadencës.

SHEQER

Treguesit shqisorë:

1.Pamja e jashtme:

pluhuri i përbërë nga kristale të imët dhe të njëjlojtë pa lëndë të huaja, të jetë i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet, pa copa sheqeri të ngjeshura ose lëndë të huaja.

Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

2.Ngjyra:

e bardhë dhe me shkëlqim.

3.Era dhe shija:

shije e ëmbël, pashije dhe erë të huaja, kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.

4.Tretshmëria:

tretet plotësisht në ujë, tretshmëria e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:

Të jetë me pako prej letre 1 kg neto. Në amballazhin të jetë shënuar edhe afati i skadencës.

MAKARONA

Treguesit shqisorë:

1.Forma:

Makarona spageti, me gjatësi 25-30 cm, me diametër 2-2.5 mm.

2.Pamja e jashtme:

Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër. Mbas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.

3.Ngjyra:

E bardhë me nuancë të verdhë, në thyerje paraqiten qelqore në jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

4.Era dhe shija:

E mirë, karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur, të thatë, të mykur dhe për çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:

Në qese telefoni me masën 500 gr, këto të future në kuti kartoni deri 12 kg. Në amballazhin 500 gr të jetë shënuar dhe afati i skadencës jo më pak se 1.5 vjet.

VAJ LULE DIELLI

Treguesit shqisorë.

- **Pamja në 20° C:** Lëng vajor, i qartë, pa depozitime.
- **Ngjyra:** E verdhë e lehtë.
- **Eradhe shija:** E mirë karakteristike e vajit lule dielli, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.

• **Përmbajtja e acideve yndyrore sipas S SH 203:2003.**

Treguesit fiziko – kimikë.

- Dendësia relative në (20⁰ C/ujë në 20⁰ C) 0,918-0,923.
- Treguesi i refrakcionit =1,461-1,468.
- Numri i sapunifikimit (mg KOH/gr vaj) 188-194.
- Treguesi i jodit 118-141.
- Lëndë të pasapunifikueshme: ≤ 15 gr/kg.
- Lëndët fluturuese në 105 gradë C jo më shumë se 0.2%.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Vaj lule dielli i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 litër, të mbyllura me tapë plastike me vidhëzim hermetik të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse. Shmangia nga vëllimi është deri +/- 1%.

Etiketimi bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën do të shënohet:

Emërtimi i plotë i mallit, data e prodhimit, afati i përdorimit.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1 vjet nga data e furnizimit në institucion.

Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mirë ose me material tjetër të përshtatshëm.

NISESHTË

Të jetë e cilësisë së parë, e stazhionuar, e ambalazhuar në pako 1 kg letre, ku të shënohet:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Sheqeri duhet të jete me treguesit fiziko- kimik: Sheqer i paster 99.6%, hiri deri 0.07%, lageshtira deri ne 0.16 %.Pamja: pluhur i perbere nga kristale te imta e te njellojta. Ngjyra: i bardhe ne shkelqim. Treguesit shqisor: i derdhur i thate, me shije te embel pa ere te huaj, perdorim te njetrajtshem, te tretet plotesisht. Ambalazhimi ne pako letre 1 kg ose thase lini ose plastmasi 50 kg dhe etiketuar sipas standartit ne fuqi.

KRIPE E JODIZUAR bazuar në STAZH 1437\01.07.1995

Treguesit cilësorë:

1. Ngjyra:

E bardhë

2. Era dhe shija:

E kripur pa shije dhe erë të hua.

3. Pamja e jashtme:

Masë kokrrizore

Treguesit fiziko kimik:

1-Imtësia në mm 0.2 – 2 .

2-Klorur Na në lëndën e thatë në %, jo më pak se 98.

3- Klorur Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

4-Sulfat Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.9.

5-Sulfat Ca në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.2.

6-Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

7-Lagështirë në %, jo më shumë se 1.

8-Jodur kaliumi mg/kg 50 (+/-) 3

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno shëndetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetsisë.

Markërimi:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ambalazhimi:

Të bëhet në qese të pastër ose polietileni ushqimor, opak me masë 1 – 25 kg. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raport analize të laboratorit

SALCË DOMATESH

Kërkohet salcë domate e ambalazhuar në kuti llamarine ose shishe qelqi.

Kutia të jetë e mbyllur hermetikisht dhe e mbështjellë me etiketë të përkthyer në gjuhën shqipe kur malli është i huaj.

Përmbajtja të jetë salcë dhe kripë.

Përbërja e lëndës së thatë të jetë 20 % + 1.

Nuk lejohen përbërës të tjerë dhe lëndë të huaja.

Ngjyra e salcës të jetë e kuqe e thellë.

Shija të jetë karakteristike e salcës së domates pa shume aciditet.

Aroma të jetë e këndshme në përputhje me aromën e domates së freskët karakteristike e llojit. Në etiketë të jetë shënuar qartë firma prodhuese, data e prodhimit dhe përdorimit. Treguesit fiziko-kimikë dhe ambalazhimi të jenë sipas STASH 1429-87.

ARTIKULLI: ÇAJ MALI

Të jetë i cilësisë së parë, i tharë mirë, boçja e plotë dhe i ambalazhuar në pako ose me tufa. Pa lëndë të huaja. Pa erë dhe shije myku. Nuk pranohet çaj me bustin. Operatori ekonomik nga çdo prodhim ose grumbullim të caktuar nga i cili bën furnizimin në institucionet e përkujdesit, të ketë certifikatë fito sanitare.

“FASULE”

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

- Pamja e jashtme: kokrra të plota, të shëndosha, me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale, e rrumbullakët, e gjatë, etj) me gjatësi 8- 13 mm.
- Ngjyra: e bardhë.

Era dhe shija: pa erë myku dhe çfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo ere tjetër të huaj.

Frutat(molla,portokalle)

Kerkohet pa deformime, me pjekuri teknike te njejte, te shendosha, te pastra, te zhvilluara normalisht, pa ere e shije te huaj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport analize origjinale ose kopje e noterizuar, leshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i references, për produktet e ofruara.

Raport analiza perkatese duhet te jete sipas llojit te produktit, dhe jetegjatesise se produktit dhe te kete lidhje me produktin/mostren e ofertuar. Ne kete raport analize duhet te jete shenuar: emeri i produktit ose nje e dhene tjetere qe tregon ose lidh kete raport analize me produktin e ofertuar.

Produkti kur te levrohet, duhet te jete i shoqeruar me certifikaten e origjines dhe flete analize per treguesit e sigurise, sipas legjlistacionit ne fuqi per ushqimin.

Te gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike te produktit te ofertuar/mostres qe perfaqesojne artikullin duhet te perputhen plotesisht me treguesit e shenuar ne specifikime teknike dhe te Standartit Shteteror perkates. Standartet shteterore per karakteristikat e produkteve ushqimore jane te disponueshme dhe jane te publikuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit (DPS) ne faqen e internetit www.dps.gov.al

Produktet ushqimore objekt i Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr 1344 date 10.10.2018 Per miratimin e rregullave per etiketimin e produkteve ushqimore'heni 4 dhe 13 te jene te pajisura me etiketat respektive"

Automjetet e perdorura per transportimin e produkteve duhet te jene te pajisura me mates

temperature (tahograf) per gjurmimin e temperatures gjate levizjes te mjetit.

Frigoriferet e instaluar ne ambjentet e operatorit ekonomik te kene regjistrat perkates per monitorimin e temperatures, sipas Udhhezimit te Ministrit te Bujqesise Nr 22 date 25.11.2010 “Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operoret e biznesit ushqimor”.per lotin 2


Per sa i perket specifikimeve teknike per produktin “mish/i perpunuar mish” per Autoriteti Kontraktor kerkon ne specifikimet teknike qe: Pjesa e kerkeses (shpatull, kofshe dhe gjoks) duhet te jete e vulosur me vulen e kontrollit veterinar.

Çdo parti/kerkese mishi duhet te shoqerohet me certificate veterinare, e cila garanton sigurine e produktit “mish” dhe me te cilen vertetohet se, nga kontrolli i kryer nuk eshte prekur nga semundje, por qe eshte i sigurt dhe se lejohet te tregetohet per konsum publik.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.



Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

OBJEKTI: "BLERJE USHQIMESH PER NEVOJAT E DREJTORISE SE SHERBIMIT SPITALOR POGRADEC "

Nr	Pershkrimi I mallrave	Njesia	Sasia e perafert	Cmimi	Vlera pa tvsh
3	Djath I bardhe	Kg	1250		
4	Gjalpe	Kg	420		
5	Mish vici	kg	600		

Dokumentat Standarde të Tenderit

6	Mish pule (kofshe pule)	Kg	1000		
1	Buke gruri	Kg	6000		
2	Qumesht lope I fresket	Litra	7100		
7	Vaj lule dielli	Kg	850		
8	Oriz	Kg	870		
9	Sheqer	Kg	480		
10	Makarona	Kg	900		
11	Miell gruri	Kg	700		
13	Salce domate	Kg	80		
14	Fasule	Kg	50		
15	Rigon (30gr)	pako	250		
16	Sode buke (30gr)	Pako	360		
17	Limantoz (30gr)	Pako	250		
18	Recel	Kg	500		
19	Niseshte	Kg	120		
20	Kripe	Kg	210		
21	Piper I kuq (30gr)	Pako	360		
22	Caj mali 100gr	Tufa	200		
23	Makarona fide	Kg	150		
24	Domate	Kg	300		
25	Karota	Kg	200		
26	Patate	Kg	1400		
27	Presh	Kg	500		
28	Specat e fresketa	Kg	450		
29	Patellxhana	Kg	250		
30	Qepe te thata	Kg	500		
31	Mashurka	Kg	130		
32	Kungulleshka	Kg	100		
33	Bamje	Kg	100		
34	Veze pule cilesia pare	Kokrra	25066		
35	Spinaq	Kg	150		
36	Kastraveca	Kg	10		
37	Molle	Kg	20		
38	Portokalle	Kg	20		
39	Cokollata (30 gr)	Cop	170		
40	Leng frutasah	Liter	170		
	Vlera			4621.5	3800000
	Tvsh 20%			924.3	760000
	Totali me tvsh			5545.8	4560000

Shenim

1 Shumatoraja e cmimeve per njesi pa tvsh eshte 4621.5 Leke (katerrmijeegjashteqindenjezetenje pikepese) referuar udhezimit nr. 6, date 16.01.2018 "Per perdorimin e marreshjes kuader dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"te Agjencise se Prokurimit Publik, si dhe rekomandimit Nr 10419 prot, dt 26/11/2018 "Mbi perdorimin e marreshjes kuader"

2. Artikujt e mesiperm do te perdoren per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Pogradec .
3. Te jene brenda standareve te miratuara.
4. Furnizimi te behet sipas grafikut

Afatet e levrimit: Nga momenti i lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e marreshjes kuader 12(muaj) .



Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës

Dokumentat Standarde të Tenderit

01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Dokumentat Standarde të Tenderit

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >



Shtojca 13

Public Health Sector

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera _____ (me numra dhe fjalë)	
2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera _____ (me numra dhe fjalë)	
Etj. _____	

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat –Kërkesë për propozim**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi,

kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
